



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
JANAR 2025

Tiranë më 31.01.2025

1.	19.12.20 24	1.A ushtrohet veprimtari minerare me karrierë (gurore) në fshatin Berdicë (në zonën e mbrojtur dhe jashtë	06.01.2024	Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të lejeve Mjedisore dhe VNM-ve qëndrimi si më poshtë: Lejet Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C dhe licencat me kod III.2.B janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë”. Linku pranë QKB-së për lejet dhe licencat:	Përfunduar	Nuk ka
----	----------------	---	------------	---	------------	-----------

	<p>saj)? Nëse po, a janë dhënë leje mjedisore për ushtrimin e këtyre veprimtarive minerare me karrierë (gurore)? Na vendosni në dispozicion kopje të lejeve mjedisore dhe të gjithë dokumentacionit mbi të cilat është miratuar leja mjedisore?</p> <p>2. A janë ushtruar inspektimi në lidhje me veprimtarinë minerare me karrierë (guroret) në fshatin Berdicë? Nëse po ju lutem na</p>		<p>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/</p> <p>Në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar linku me lejet e mjedisit dhe licencat:</p> <p>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/</p> <p>Për një informacion më të saktë e më të detajuar lutemi të na vini në dispozicion emrin e operatorëve ose të dhënat e ekstraktit me numër NUIS përkatës me qëllim identifikimin e tyre. Ju sjellim në vëmendje së për kërkesën specifike mbi operatorët e pajisur me leje mjedisore, Ju duhet t'i drejtoheni QKB-së e cila mban dhe administron regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve.</p> <p>Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, bëhet me dije se :</p> <p>Në përgjigje të kërkesës së ardhur në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, ju informojmë që në fshatin Berdicë, Shkodër, nuk ushtrohet veprimtari minerare "Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret " (guroret).</p>		
--	---	--	---	--	--

		<p>vendosni në dispozici-on kopje të raporteve të inspektimev e të kryera.</p> <p>3. A janë dorëzuar raporte dhe plane për rehabilitimin e mjedisit për veprimtarinë e kryer nga ana e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në fshatin Berdicë?</p> <p>Nëse po ju lutem na vendosni në dispozicion kopje të raporteve të dorëzuar?</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>4. A janë bërë studime në fshatin Berdicë në lidhje me nivelin e ndotjes, cënimin e faunës apo florës nga ushtrimi i veprimtarisë minerare me karrierë (guroret)?</p> <p>5. A janë marrë masa për rehabilitimin e zonës dhe mbrojtjen e faunës dhe florës në këtë zonë?</p>				
2.	08.01.2025	Banorët e fshatit Zicisht, Njësia Administrative Miras, Devoll	13.01.2025	Referuar VKM Nr.568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” struktura kontrolluese e agjencisë inspekton vetëm subjektet që ushtrojnë veprimtari të ligjshme, për të garantuar përputhshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë me kërkesat ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore apo kushtet e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.	Përfunduar	Nukka

		<p>prashtrojnë si problem të hershëm për të cilin nuk kemi marrë zgjidhje ndër vite nga institucionet përgjegjëse. Në qendër të fshatit është një godinë e degraduar e cila më parë ka luajtur rolin e “Pallatit të Kulturës” është e mbuluar me material eterniti, një material ky kancerogjen . Pavarësisht faktit që ky material ndalohet me ligj në vendin tonë, ai vazhdon të jetojë pikërisht në</p>		<p>Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i cili midis të tjerave citon se “<i>kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrative dhe mungesa e kushteve e standarteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve që krijohen brenda territorit të njësisë të qeverisjes vendore ngarkohen me përgjegjësi drejtuesit e këtyre njësive</i>” të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të VKM Nr.515/2019 “Për një shtesë në vendimin Nr.502/2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme” të ndryshuar, neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit” të ligjit Nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar si dhe pikës 3 të Urdhërit Nr.29 /2023 të Kryeinspektorit z.Shkëlqim Hajdari “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushë veprimtarinë inspektuese të mjedisit për Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” kërkojmë nga ana Juaj angazhimin e strukturave tuaja, brenda kompetencave ligjore, si dhe vënien në dijeni për trajtimin/zgjidhjen e problemit të banorëve të fshatit Zicisht, Njësia Administrative Miras.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

	<p>këtë godinë e cila nuk ka asnjë funksion. Me kalimin e kohës nën ekspozimin e agjentëve atmosferikë dielli, i ftohti, i nxehti, shiu, cimentoja gërruhet, erodohet dhe fijet ekspozohen ndaj erës dhe hyjnë në përbërje të ajrit. Nga ajri mund të hyjnë në brendësi të trupit të njeriut nëpërmjet frymëmarrjes duke shkaktuar sëmundje shumë të rënda. Sëmundja “asbestoza” shkakton një</p>				
--	---	--	--	--	--

		<p>fryrje dhe korëzim të indeve të mushkërive, që rrit ndjeshëm mundësinë e kancerit në mushkëri. Ndër vite banorët e shtëpive përreth kanë shfaqur problem shëndetësor e.</p> <p>Ligji Nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar ka parashikuar qartë se cilat janë “mbetje të rrezikshme” të cilat janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e</p>				
--	--	--	--	--	--	--

	<p>rezikshme, të listuara në shtojcën 3, bashkëlidhu r këtij ligji. <i>H 5</i> <i>“Dëmtuese”</i> <i>Substancat</i> <i>dhe</i> <i>preparatet</i> <i>që në qoftë</i> <i>se thihthen</i> <i>përmes</i> <i>rrugëve të</i> <i>frymëmarrje</i> <i>s ose</i> <i>gëlltiten ose</i> <i>në qoftë se</i> <i>depërtojnë</i> <i>në lëkurë,</i> <i>mund të</i> <i>përfshijnë</i> <i>rreziqe të</i> <i>limituara</i> <i>për</i> <i>shëndetin.</i></p> <p><i>H 7</i> <i>“Kancerogj</i> <i>ene”</i> <i>Substancat</i> <i>ose</i> <i>preparatet</i> <i>që në qoftë</i> <i>se thithen</i> <i>përmes</i></p>				
--	--	--	--	--	--

	<p><i>rrugëve të frymëmarrjes, gëlltimit apo depërtojnë në lëkurë, mund të shkaktojnë kancer ose të rrisin mundësinë për shfaqjen e tij.</i></p> <p>Ligji Nr.9010/2003 “Për administrimin mjedisot të mbetjeve të ngurta” i ndryshuar ka parashikuar qartë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor</p>				
--	--	--	--	--	--

	<p>të tyre dhe në cdo fazë.</p> <p>Ndodhur të pafuqishëm në zgjidhjen e kësaj situate shumë të rëndë për shëndetin tonë, kërkojmë ndërhyrjen tuaj dhe të agjencive rajonale të cilat kanë për detyrë administrimin mjedisor të mbetjeve dhe kontrollin e zbatimit të tij në të gjitha nivelet, duke hequr dhe asgjësuar materialin e mbulesës së këtij objekti dhe restaurimin</p>				
--	--	--	--	--	--

	<p>e tij për t'iu rikthyer aktiviteve kulturore dhe artistike.</p> <p>Legjislativi i sipërcituar parashikon qartë se në territorin e RSH janë të ndaluara braktisja, shkarkimi, hedhja në tokë ose në ujërat sipërfaqësorë e mbetjeve që cojnë në degradimin e vetive të tokës ose të ujërave sipërfaqësorë dhe shkaktojnë rrezik ose dëm për shëndetin dhe mjedisin.</p>				
--	---	--	--	--	--

3.	08.01.2025	Në lidhje me aplikimin e subjektit “Koorporata Elektro-energjetike Shqiptare” sh.a, në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidro-centrali i Skavicës”, me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit e cila është refuzuar automaticisht nga sistemi i e_lejeve, pas tejkalimit të afatit ligjor, desha te di nëse:	09.01.2025	Subjekti nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM të thelluar.	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	------------	--------

		<p>1. Nëse subjekti Koorporata Elektro-energjetike Shqiptare sh.a ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar.</p> <p>2. Nëse po, mund të më nisni dokumentat përkatëse të aplikimit.</p>				
4.	27.12.2024	<p>Cilat janë kompanitë e licensuara që asgjësojnë këto lloj mbetjesh sipas listës të mëposhtëme :</p> <p>1.13 02 04* Vajra motori ingranazh-</p>	07.01.2025	<p>Operatorët e pajisur me leje mjedisit me kod III.1.C dhe licenca të nënkategorisë III.2.B janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB bazuar në ligjin nr.10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH”.</p> <p>Në linkun e mëposhtëm mund të verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-komberar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licencat-lehjet-e-leshuara-nga-qkb/</p> <p>Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve ka për qëllim të sigurojë aksesin e lirë të publikut në përputhje me ligjin.</p>	Përfunduar	Nuk a

	<p>esh dhe lubrifikues të klorinuar me bazë minerale</p> <p>2. 13 02 05* Vajra motori, ingranazhesh dhe lubrifikues të pa klorinuar me bazë minerale</p> <p>3. 16 06 01* Bateri Plumbi</p> <p>4. 16 06 02* Bateri Ni-Cd</p> <p>5. 16 06 03* Bateri që kanë mërkur</p> <p>6. 16 06 06* Elektrolite të ndara të mbledhur nga bateri dhe akumulatorë të tjerë</p> <p>Për ato kompani që kanë marrë</p>		<p>Gjithashtu ju informojmë se në faqen zyrtare të AKM është publikuar lista e subjekteve për periudhën 2014- Tetor 2024</p> <p>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/</p> <p>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-peridhen-2012-maj-2024/</p> <p>për një informacion më të saktë mbi operatorët të pajisur me leje mjedisi ju duhet ti drejtoheni QKB-së e cila mand dhe administron regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve.</p>		
--	---	--	--	--	--

		leje për asgjësimin e këtyre mbetjeve lutemi të na vini në dispozicion një kopje të tyre.				
5.	10.01.2025	Referuar ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” kërkojmë nga ju, si organi kompetent për ndjekjen e procedurave sipas legjislacionit në fuqi për VNM-të, një kopje të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektin e rehabilitimit të Përroit të Lubonjës	17.01.2025	Nga verifikimi i kryer në databasë-n e VNM-së, nuk rezulton të ketë aplikim nga Bashkia Korçë për "Rehabilitimin e Perroit të Lubonjës".	Përfunduar	Nukka

		nga Bashkia Korçë që po zbatohet.				
6.	-Sipas Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga viti 2020-2024 janë transferuar 20 mijë ton mbetje të hirit të oxhakut, e konsideruar mbetje e rrezikshme, nga Kompania KURUM për kompaninë Sokolaj sh.p.k. Pse nuk është kryer asnjë	13.01.2025	17.01.2025	<p>Në vijim të informacionit të kërkuar, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Subjekti KURUM International sha, është inspektuar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përkatësisht nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë 8 (tetë) herë nga viti 2020 deri në vitin 2024, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspektim datë 01/10/2020, Cështje Nr. AKM-BR-2020-000051, Nuk ka shkelje të kërkesave ligjore • Inspektim datë 25/11/2021, Cështje Nr. AKM-BR-2021-000228, Nuk ka shkelje të kërkesave ligjore • Inspektim datë 13/05/2022, Cështje Nr. AKM-BR-2022-000073, Nuk ka shkelje të kërkesave ligjore • Inspektim datë 13/05/2022, Cështje Nr. AKM-BR-2022-000074, Nuk ka shkelje të kërkesave ligjore • Inspektim datë 14/06/2022, Cështje Nr. AKM-BR-2022-000079, Nuk ka shkelje të kërkesave ligjore • Inspektim datë 09/11/2023, Cështje Nr. AKM-BR-2023-000187, Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE" i ndryshuar Neni 62, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë: <p>1. Dënim administrativ kryesor:</p>	Përfunduar	Nuk ka

	inspektim në kompaninë KURUM ?			<p>Gjobe 1500000 Lekë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspektim datë 25/07/2024, Cështje Nr. AKM-BR-2024-000155, Nuk ka shkelje të kërkesave ligjore • Inspektim datë 25/07/2024, Cështje Nr. AKM-BR-2024-000157, Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të Ligji Nr.10 448, datë 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT" i ndryshuar, nenit/neneve 29, Pika 1, b) i, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë: <p>1. Dënim administrativ kryesor:</p> <p>Gjobe 1500000 Lekë</p> <p>2. Dënim administrativ plotësues:</p> <p>- Pezullimi i aktivitetit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme deri në momentin e lidhjes së kontratës/ve përkatëse me një subjekt të licensuar për trajtimin/asgjësimin përfundimtar të tyre.</p>		
7.	16.01.2025	Jam duke mbledhur të dhëna në lidhje me Kaskadën Kacinar dhe Shoqëria "Shpërdhaza Energji" Shpk dhe kërkojmë	17.01.2025	<p>Nga kontrolli në regjistrin kombëtar të autorizimeve lejeve dhe licencave në QKB rezulton se subjekti "Shpërdhaza Energji" shpk me NUIS: L59517003U nuk disponon Leje Mjedisi Kod III.1 (Tipi A dhe B) apo licencë të nënkategorisë III.2.B.</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, bazuar në ligji nr.119 "Për të drejtën e informimit", ju bëjmë me dije se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga kontrolli në regjistrin kombëtar të autorizimeve lejeve dhe licencave në QKB 	Përfunduar	Nuk ka

		nga ju të gjitha Lejet (deklarata) Mjedisore dhe Licensat që janë dhënë prej jush për këtë projekt, nëqoftëse ka ndonjë, si dhe dëgjesat publike shoqëruese dhe suportuese të këtyre lejeve për periudhën 2015 deri tek 16 Janar 2025.		<p>rezulton se subjekti "Shpërdhaza Energji" shpk me NUIS: L59517003U nuk disponon Leje Mjedisi Kod III.1 (Tipi A dhe B) apo licencë të nënkategorisë III.2.B.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për subjektin HEC "Shpërdhaza Energji" SHPK, Kaçinar, rezultojnë vendimet e vlerësimit paraprak si bashkëlidhur. <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", Neni 20 pika 5. <i>Nëse veprimtara apo projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës apo vendimi për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.</i></p> <p>Procedura e aplikimit kryhet nëpërmjet platformës qeveritare "e-Albania", në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 153 Prot, datë: 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020".</p> <p>Nga mbikqyrja e databazes per subjektin "Shpërdhaza Energji" rezultojne vendimet te cilat i gjeni bashkelidhur.</p>		
8.	27.01.2025	1. Ku i depozitojnë aktualisht mbetjet që nxjerrin nga gropat e pallateve kompanitë e ndërtimit në Tiranë?	03.02.2025	<p>Bazuar në Ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, Vendimit Nr. 402 me datë 30.06.2021, "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve" Vendimit Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", ndryshuar, Vendimit Nr. 371, datë 11.06.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Mjedisit Nr. 135 datë 16.04.2015 "Për Miratimin e Mënyrës së Administrimit të Formatit të Regjistrimit të Transfertave Individuale dhe të</p>	Përfunduar	Nuk ka

	<p>2. Prej sa muajsh landfilli i Sharrës nuk i pranon këto mbetje? Pse është krijuar kjo situatë?</p> <p>3. A ka kryer Ministria e Mjedisit dhe AKM kontrole se ku i depozitojnë mbetjet firmat e ndërtimit?</p> <p>4. Në sa raste keni konstatuar shkelje? Ku i kanë hedhur këto mbetje?</p> <p>5. Sa gjoba keni vendosur për hedhjen e mbetjeve në vende që</p>	<p><i>Regjistrit Kombëtar të Transfertave si dhe Mënyrën e Administrimit të tyre</i>”, në raportimin e transfertave individuale të subjekteve të cilat kanë raportuar në AKM në periudhën 1-15 Maj dhe 1-15 Nëntor, për kodin "17 05 04 - Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03", rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sasia e deklaruar në maj 2024 (Nëntor 2023-Prill 2024) është 83 798. 66 Ton të dërguara në kompaninë IEBV SPV dhe 27 972. 440 ton në kompaninë K.I.D.Alb. • Sasia e deklaruar në Nëntor 2024 (Maj -Tetor 2024) është 36479. 34 Ton të dërguara në kompaninë IEBV SPV. <p>Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM- ka kthyer përgjigje me e-mail për sa ka kompetencë:</p> <p>Nga sa kërkohet deri në pikën 6 ju informojmë se nuk janë në kompetencë të Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve.</p> <p>Për sa i përket pikës 6 ju informojmë se në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është publikuar një listë me subjektet e pajisura me leje mjedisi. Link bashkëngjitur: https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/</p> <p>Gjithashtu ju informojmë se për një informacion më të saktë mbi Lejet mjedisore dhe licencat janë të publikuara në regjistrin e lejeve licencave dhe autorizimeve pranë QKB-së. Link bashkëngjitur: https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/</p>		
--	---	---	--	--

		<p>nuk lejohen?</p> <p>6. Sa vende të ligjshme ka miratuar ministria e Mjedisit për hedhjen inerteve, cilat janë ato?</p>	<p>Nga Drejtoria e Inspektim Kontrollit:</p> <p>Referuar kërkesës për informacion nga ana e gazetarit Besmir Pula, për televizionin MCN TV, ju bëjmë me dije se; Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër, sipas planeve mujore janë realizuar 78 inspektime (VNM) në periudhën Janar 2024 - Gusht 2024. Nga periudha Shtator 2024 deri më sot, nuk kemi realizuar inspektime në fushën e VNM-së. Nga 78 inspektimet e realizuara janë marrë 5 masa administrative me Gjobjë, për shkeljen e kushteve të VNM-së.</p> <p>Sa i përket vendepozitimeve informale, institucioni përgjegjës për evidentimin dhe bllokimin e tyre është Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT).</p>		
--	--	---	---	--	--